



Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit

Nr.07/351/01-24221

Dt. 26.12.2017

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit duke vendosur sipas kërkesës së parashtruar nga: **Faik Tabaku** nga Gjakova, për dhënie e Lejes së Ndërtimit, për ndërtimin e objektit të kategorisë së parë, me destinim objekt i banimit individual – shtëpi familjare, me etazhitet B+ P+1, në bazë të Ligjit për Ndërtim, Nr. 04/L-110, nenet 14, 15, 19, 20 dhe 21, si dhe Ligjit për Procedurën Administrative Nr. 05/L-031 nenit 21, 44 dhe 97 bien këtë:

AKTVENDIM

- I. I LEJOHET:** aplikuesit: **Faik (Avdullah) Tabakut** nga Gjakova, ndërtimi i objektit të kategorisë së parë, me destinim objekt i banimit individual – shtëpi familjare, sipas projektit ideor të prezentuar, në përputhshmëri me Planin Zhvillimor Urban dhe Vendimit për Kushte Ndërtimore me numër 07-351/01-20109 të datës 19.10.2017, të lëshuar nga DUMM, në ngastrën kadastrale me numër 774-1, Z.K. Gjakovë Qytet, në pronësi të lartë përmendurit, e cila ka vijën e ndërtimit dhe rregullimit të definuar dhe të prezantuar në planin e situacionit me të gjithë parametrat tjerë përcjellës për ndërtimin e objektit në fjalë, etazhiteti i objektit është B+P+1, me sipërfaqe të përgjithshme (bruto) të objektit $S = 265.75 \text{ m}^2$.

Bodrumi;	(Sip.Bruto):	$S = 47.25 \text{ m}^2$
Përdhesa:	(Sip.Bruto):	$S = 113.35 \text{ m}^2$
Kati i parë:	(Sip.Bruto):	$S = 105.15 \text{ m}^2$

VËREJTJE:

- Megenëse objekti është i kategorisë I-rë, sipas Udhëzimit Administrativ të MMPH nr.06/2017 neni 8.5 nuk kërkohet Projekti kryesor, por i njëjti kërkohet të jetë në vend ndërtim para se të fillojë ndërtimi.
- Projekti i ndërtimit të realizuar dorëzohet për aplikim për Certifikatë të Përdorimit (neni 9.3)

II. Hartimin e projektit ideor me destinim: ndërtimi i objektit të banimit individual – shtëpi familjare dyshe, nga pika 1 e këtij aktvendimi e ka bërë NSHIPN "HARP"- Gjakovë.

III. Pjesë përbërëse e këtij aktvendimi është Plan Situacioni i lokacionit me objektin sipas vijës së ndërtimit dhe rregullimit, e përshkruar në situacionin grafik për të cilin është dhënë pëlqimi përkatës nga kjo Drejtori i cili është bazë për rilevimin gjeodezik të objektit nga pika 1 e këtij aktvendimi.

IV. Investitori është i obliguar që:

- Të të ruaj një ekzemplar original të dokumentacionit teknik në bazë të të cilit i është dhënë kjo Leje Ndërtimi;
- Pa pëlqimin e hartuesit të projektit ideor dhe pëlqimin e kësaj Drejtorie, të mos bëjë asnjë ndryshim në projekt;
- Ekzekutimi i punimeve nga pika 1 e këtij Aktvendimi, të realizohet nën mbikëqyrjen e organit mbikëqyrës për realizimin e ndërtimit të objektit.
- Të lajmëroj Drejtorinë e inspektionit për ditën e fillimit të punës së paku 8(tetë) ditë para fillimit të ndërtimit, me qëllim të verifikimit dhe përcjelljes së punimeve:

V. Kjo Leje Ndërtimi vlen 1(një) vit nga dita e lëshimit të këtij aktvendimi.

Arsyetim

Faik (Avdullah) TABAKU nga Gjakova, me banim në rrugën: BAJRAM CURRI Nr.42, ka parashtruar kërkesën pranë DUMM me nr. 07/351/01-24221 të datës 08.12.2017 për dhënien e Lejes së Ndërtimit për ndërtimin e objektit të kategorisë së parë, me destinim objekt i banimit individual – shtëpi familjare, me etazhitet B+P+1, në ngastrën kadastrale me numër 774-1, Z.K. Gjakovë Qytet, siç është përshkruar në pikën 1 të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Së bashku me kërkesën investitori e ka prezantuar edhe këtë dokumentacion:

1. Planin e Situacionit në përpjesë 1:500 të datës 08.09.2017, të vërtetuar nga DUMM- Gjakovë.
2. Kopjen e planit të datës 12.09.2017 (fotokopje) në pronësi të Faik (Avdullah) Tabakut nga Gjakova , të lëshuar nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë.
3. Certifikatën mbi të drejtën në pronë e paluajtshme (fotokopje) me numër të lëndës 4493/17, të datës 07.09.2017, të lëshuara nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë.
4. Vendimin për Kushtet Ndërtimore me numër 07-351/01-20109 të datës 19.10.2017 të lëshuar nga DUMM.
5. Vërtetimin mbi kryerjen e obligimeve nga tatimi në pronë, numër 430-L-4147, të datës 18.09.2017.
6. Pëlqimin nga KEDS-Gjakovë, nr.1883 të datës 13.11.2017.
7. Pëlqimin nga K.R.U. "Radoniqi" Sh.A.Gjakovë, nr. 3069 të datës 03.11.2017.
8. Pëlqimin nga PTK-Gjakovë, dt. 31.10.2017.
9. Dëshminë mbi kryerjen e obligimeve nga taksa administrative dhe tarifa rregullative për rritjen e densitetit në IFJB CAPITAL sh.p.k.- Gjakovë, me datë 14.12.2017.
10. Projektin Ideor në 3 (tri) kopje të forta dhe 1(një) CD, i punuar nga NSHIPN"HARP"- Gjakovë.


Taksa administrative dhe tarifa rregullative për rritjen e densitetit është paguar në vlerën prej 687.49 Euro.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij Aktvendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 30 ditësh, duke u llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim. Ankesa i parashtrohet Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në Prishtinë, dhe e njëjta dorëzohet nëpërmjet kësaj Drejtorie.

Aktvendimi i dorëzohet:

- Investitorit,
- Drejtorisë së Inspekcionit,
- Arkivit.

Zyrtar i lartë për çështje juridike

Zenel Shabani, jur. i dipl.

Drejtori


/ Arben Bakalli jurist /

K.K. GJAKOVË
Z.k.Gjakove Qytet
Parcela:774-1

PLAN SITUACIONI

Matjet jane kryer me gps kopos dhe total station

Kos-Reef



- Gjendja kadastrale
- Gjendja ekzistuese

Legenda:

- Shpyll elektrike
- Rrugë ekzistuese
- puset ujësjiellësi
- ujmbledhës atmosferik
- muri

08. Shtator. 2017
Auto Cad 2012

$P = 1 : 500$

Punoi : N.SH "Geo Station"
Bch i gjeod: Shkelqim Brovina




Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor /Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja/Ministry of Environment and Spatial Planning
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT \ KOPIJA PLANA \ COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija \ Municipal Cadastral Office : GJAKOVË
Zona Kadastrale / Katastarska Zona \ Cadastral Zone : Gjakovë Qytet

Njësia \ Jedinica \ Unit	Tipi \ Vrsta \ Type	Sipërfaqja \ Poveršina \ Area m ²
P - 70705029 - 00774 - 1	Parcelë \ Parcela \ Parcel - shtëpi	223.0
	Parcelë \ Parcela \ Parcel - oborr	231.0



Shkalla / Razmera /Scale: 1:500

Punoi \ Obridio \ Created :
Data \ Data \ Date : 12.09.2017
Koha \ Vreme \ Time : 11:20:15
Nënshkrimi \ Potpis \ Signature:
Shënim \ Beleška \ Note :

Aprovoi \ Usvojió \ Approved : Drejtori \ Direktor \ Director
Nënshkrimi \ Potpis \ Signature: _____

